

Ekskluzive

Ekskluzive | Bastisja për plagosjen në Skenderaj zbulon armë – në kërkim mbetet i dyshuari për tentim vrasjeje, kapet vëllai i mitur



Sinjali.com

01 Gusht 2026 22:01



Hetimet për plagosjen me armë zjarri që ndodhi në Skenderaj kanë hyrë në një fazë të re, pasi gjatë bastisjes në shtëpinë e të dyshuarit është gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri, ndërsa vetë i dyshuari vazhdon të jetë në arrati.

Sinjali mëson se i dyshuari kryesor është **Rinor Kuliqi** 19 vjeçar, ndërsa gjatë aksionit policor është intervistuar edhe vëllai i tij i mitur, A. K, 15 vjeçar.

Rasti lidhet me plagosjen e **Liridon Zekajt**, 25 vjeçar, e ndodhur mbrëmjen e 31 korrikut në rrugën "Fatmir Dibra" në Skenderaj.

Sipas burimeve, viktimja ishte qëlluar me armë zjarri në shputën e këmbës së majtë. Ai fillimisht mori trajtim në QKMF-në e Skenderajt dhe më pas në Spitalin Rajonal të Mitrovicës, nga ku u lirua pas trajtimit mjekësor.

Në vendin e ngjarjes, hetuesit kishin sekuestruar tre gëzhoja, ndërsa pas intervistimit të viktimës ishte identifikuar i dyshuari kryesor, ndaj të cilit u iniciua rasti për veprën penale "Tentim vrasjeje".

Në vazhdim të hetimeve, më 1 gusht, rreth orës 11:40, Njësia e Hetimeve Rajonale, në bashkëpunim me Policinë e Skenderajt, realizoi një bastisje në fshatin Abri e Poshtme, në shtëpinë e të dyshuarit.

Megjithatë, Rinor Kuliqi nuk u gjet në shtëpi.

Gjatë kontrollit, policia ndaloi dhe kontrollloi vëllain e tij të mitur, A. Kuliqin, te i cili në brez u gjet një armë zjarri, për të cilën dyshohet se mund të jetë përdorur në rastin e plagosjes. Arma është sekuestruar në cilësinë e provës materiale.

I mituri është intervistuar në prani të prindit dhe avokatit mbrojtës, ndërsa me urdhër të Prokurorit të Shtetit është liruar në procedurë të rregullt.

Ndërkohë, Rinor Kuliqi vazhdon të kërkohet nga Policia, ndërsa hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të rastit janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

plagosje ne Skenderaj

Sinjali

Tentim vrasje

Të tjera:



Aksident tragjik në Itali: Pesë të vdekur dhe 27 të lënduar pas përplasjes së disa automjeteve

Evropë



Biserko: Në Kosovë ka ende varreza masive të pazbuluara, Serbia nuk është përballur me...

Siguri



Do Ferrari të ri? Pritja mund të zgjasë deri në vitin 2028

Automjete



OVL e UÇK-së reagon ndaj nderimit të njësive serbe: Po institucionalizohet...

Kosovë




Rita Ora nga Ohri: Krenare që jam nga Kosova dhe që jam shqiptare

Bota e Yjeve



Alabbar pranon gabimin me Portin e Durrësit: Veprove shumë shpejt

Shqipëri



Irani mohon marrëveshjen për rihapjen e Hormuzit: "Nuk e lejojmë"

Botë



Sulm izraelit në jug të Libanit, plagosen pesë ushtarë dhe disa civilë

Botë

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtimi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumnë
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera